

20885

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATE E RRETHIT TIRANE
Nr. 20885/Vendimit.

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN E SHOQERISE "KASTPETROL"SHA

Sot, me daten 12.01.1999(nentedhjeteente), une Luigj Aliaj
Cepe, gjyqtare e Gjykates Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim
kerkesen e paraqitur nga Z. Luigj Aliaj, per miratimin e akteve te
themelimit dhe regjistrimin e shoqerise "Kastpetrol"SHA dhe

KONSTATOVA:

Z. Shefit Kastrati, me cilesine e ortakut te vetem, me daten
28.01.1999 ka vendosur themelimin e nje shoqerie tregtare me emertimin
"Kastpetrol"SHA, me statusin e shoqerise anonime pa oferte publike.
Shoqeria ka per objekt te veprimtarise importin, eksportin dhe tregtimin
brenda vendit te naftes, gazit e nenprodukteve te tyre nepermjet krijimit te
instalimeve e impianteve te pershtatshme per ushrimin e kesaj
veprimtarie. Kapitali themneltar i shoqerise eshte 2 000 000 leke dhe eshte
i likjduar teresisht ne banke. Kapitali zoterohet plotesisht nga ortaku i
vetem Shefit Kastrati. Shoqeria eshte themeluar per te vepruar per nje afat
50 vjeçar. Ajo ka seline e saj ne Shkozet te rrethit Durres. Antare te
Keshillit Mbikqyres jane caktuar Kujtim Çausllari, Ramazan Hoda e
Bilbil Kastrati. Drejtori i shoqerise eshte caktuar Luigj Aliaj. Ne keto
kushte kerkesa e paraqitur eshte e drejte, e mbeshtetur ne ligj dhe duhet
pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te
ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe
duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses. miratimin e akteve te themelimit dhe regjistrimin e
shoqerise "Kastpetrol" SHA si person juridik, me statusin e shoqerise
anonime pa oferte publike, me kapital themeltar 2 000 000 leke te zoteruar

teresisht nga ortaku i vetem Shefit Kastrati, me objekt veprimtarie importin, eksportin dhe tregtimin brenda vendit te nafes, gazit e nenprodukteve te tyre nepermjet krijimit te instalimeve e impianteve te pershtatshme per ushrimin e nje veprimtarie te tille.

Shoqeria eshte krijuar per nje afat 50 vjeçar. Ajo ka seline e saj ne Shkozet te rrethit Durres.

Antaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane Kujtim Çaushllari, Ramazan Hoda e Bilbil Kastrati.

Drejtor i Pergjithshem i shoqerise eshte caktuar Luigj Aliaj.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim.

GJYQTARE

Envera Cepo

Ge
07

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 03. 05. 2001, para meje Luigj Alijaj, gjyqtare prane gjykates se rrethit Tirane, u paraqit per shqyrtim kerkesa e bere nga ana e kerkuesit, Shefit Kastrati, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" sh.a. per depozitimimin e vendimit nr. 1, date 15. 04. 2001 dhe pasi e shqyrtova ate,

K O N S T A T O V A S E :

Shoqeria Tregtare "KASTPETROL" Sh.a. eshte rregjistruar ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr. 20 885, date 12. 02. 1999 dhe ushtron aktivitet sipas akteve te themelimit te saj.

Kerkuesi Shefit Kastrati, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" Sh.a. ka paraqitur kerkese, per depozitimimin e vendimit nr. 1, date 15. 04. 2001, i cili pasi mori ne shqyrtim propozimin e shtetasve, Luigj Alijaj dhe Shefqet Kastrati per shitjen e aksioneve te shoqerise "KASTPETROL" ne masen 90%, vendosi te shese aksionet e shoqerise "KASTPETROL", shtetasve Luigj Alijaj dhe Shefqet Kastrati ne masen 90% te kapitalit themeltar, secili ne masen 45%.

Me vendimin e mesiperm te aksionerit te vetem te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. eshte vendosur, miratimi i shitjes se aksioneve ne masen 90% ne kapitalin themeltar, kapital qe zoterohej ne masen 100% nga aksioneri i vetem z. Shefit Kastrati, dy personave dhe konkretisht shtetasve Luigj Alijaj dhe Shefqet Kastrati.

Mbi bazen e ketij miratimi te dhene me vendimin e mesiperm te aksionerit te vetem konform ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", eshte perpiluar para noterit edhe kontrata e shit - blerjes se kuotave (aksioneve) te kesaj shoqerie, e cila mban daten 28. 04. 2001 dhe me nr. 270 kol e nr. 42 rep. Keshtu me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesi Shefit Kastrati e humbet pronesine e tij, perkatesisht ne masen 90% te aksioneve te tij ne kapitalin themeltar te Shoqerise "KASTPETROL" Sh.a. Ne kete menyre shitesi Shefit Kastrati me shitjen e 90 % te kuotave te tij ne kapitalin fillestar te shoqerise mbetet perseri aksioner ne kete shoqeri, por me nje zoterim te kuotave ne kapitalin themeltar aksioner ne masen prej 10%.

Bleresat Luigj Alijaj e Shefqet Kastrati behen pronar te pjeses se shitur prej 90 % te kuotave duke u futur ne shoqeri me te gjitha te drejtat dhe detyrimet dhe duke qene sejcili bashkeaksioner ne masen prej 45 % te kuotave ne kapitalin fillestar te shoqerise.

Shoqeria "KASTPETROL" Sh.a. pas kesaj shit - blerje do te kete si aksionere, bleresat Luigj Alijaj, Shefqet Kastrati dhe shitesin Shefit Kastrati, duke zoteruar sejcili perkatesisht :

1. Z. Shefqet Kastrati zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar.
2. Z. Luigj Alijaj zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar.
3. Z. Shefit Kastrati zoteron 10% te aksioneve ne kapitalin themeltar.

Me kete operacion shit -blerje ndryshojne edhe dispozitat perkatese te statutit. Keshtu, kapitali themeltar i shoqerise do te jete 2. 000. 000 leke, nga te cilat 45 % i perkasin Z. Luigj Alijaj, 45 % i perkasin Z. Shefqet Kastrati dhe 10 % i perkasin Z. Shefit Kastrati.

Per sa mesiper kerkesa e paraqitur per depozitim e vendimit nr. 01, date 15. 04. 2001 te aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" Sh.a. eshte plotesisht e bazuar dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit 7667, date 28.01. 1993 "Per rregjistrin tregtar"

VENDOSA :

1. Pranimin e kerkeses se bere nga ana e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" Sh.a.
 2. Depozitim e vendimit nr. 1 date 15. 04. 2001 te aksionerit te vetem te Shoqerise "KASTPETROL" Sh.a., per shit - blerjen e kuotave ne masen 90 % te kesaj shoqerie ne kete menyre :
Z. Shefqet Kastrati zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar.
Z. Luigj Alijaj zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar
Z. Shefit Kastrati zoteron 10% te aksioneve ne kapitalin themeltar
 3. Urdherohet zyra e rregjistrin tregtar te beje ndryshimet perkatese.
- Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

Dr. N. C. C. C.
[Signature]

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 03.05. 2001, para meje Smilda Cafa, gjyqtare prane gjykates se rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e bere nga ana e kerkuesit, Shefit Kastrati, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" sh.a. per depozitimin e vendimit nr. 1, date 15. 04. 2001 dhe pasi e shqyrtova ate,

K O N S T A T O V A S E :

Shoqeria Tregtare "KASTPETROL" Sh.a. eshte rregjistruar ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr. 20 885, date 12. 02. 1999 dhe ushtron aktivitet sipas akteve te themelimit te saj.

Kerkuesi Shefit Kastrati, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" Sh.a. ka paraqitur kerkesa, per depozitimin e vendimit nr. 1, date 15. 04. 2001, i cili pasi mori ne shqyrtim propozimin e shtetasve, Luigj Alijaj dhe Shefqet Kastrati per shitjen e aksioneve te shoqerise "KASTPETROL" ne masen 90%, vendosi te shese aksionet e shoqerise "KASTPETROL", shtetasve Luigj Alijaj dhe Shefqet Kastrati ne masen 90% te kapitalit themeltar, secili ne masen 45%.

Me vendimin e mesiperm te aksionerit te vetem te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. eshte vendosur, miratimi i shitjes se aksioneve ne masen 90% ne kapitalin themeltar, kapital qe zoterohet ne masen 100% nga aksioneri i vetem z. Shefit Kastrati, dy personave dhe konkretisht shtetasve Luigj Alijaj dhe Shefqet Kastrati.

Mbi bazen e ketij miratimi te dhene me vendimin e mesiperm te aksionerit te vetem konform ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", eshte perpiluar para noterit edhe kontrata e shit - blerjes se kuotave (aksioneve) te kesaj shoqerie, e cila mban daten 28. 04. 2001 dhe me nr. 270 kol e nr. 42 rep. Keshtu me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesi Shefit Kastrati e humbet pronesine e tij, perkatesisht ne masen 90% te aksioneve te tij ne kapitalin themeltar te Shoqerise "KASTPETROL" Sh.a. Ne kete menyre shitesi Shefit Kastrati me shitjen e 90 % te kuotave te tij ne kapitalin fillestar te shoqerise mbetet perseri aksioner ne kete shoqeri, por me nje zoterim te kuotave ne kapitalin themeltar aksioner ne masen prej 10%.

Bleresat Luigj Alijaj e Shefqet Kastrati behen pronar te pjeses se shitur prej 90 % te kuotave duke u futur ne shoqeri me te gjitha te drejtat dhe detyrimet dhe duke qene sejcili bashkeaksioner ne masen prej 45 % te kuotave ne kapitalin fillestar te shoqerise.

Shoqeria "KASTPETROL" Sh.a. pas kesaj shit - blerje do te kete si aksionere, bleresat Luigj Alijaj, Shefqet Kastrati dhe shitesin Shefit Kastrati, duke zoteruar sejcili perkatesisht :

1. Z. Shefqet Kastrati zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar.
2. Z. Luigj Alijaj zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar.
3. Z. Shefit Kastrati zoteron 10% te aksioneve ne kapitalin themeltar.

Me kete operacion shit -blerje ndryshojne edhe dispozitat perkatese te statutit. Keshtu, kapitali themeltar i shoqerise do te jete 2. 000. 000 leke, nga te cilat 45 % i perkasin Z. Astrit Alijaj, 45 % i perkasin Z. Shefqet Kastrati dhe 10 % i perkasin Z. Shefit Kastrati.

Per sa mesiper kerkesa e paraqitur per depozitimin e vendimit nr. 01, date 15. 04. 2001 te aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" Sh.a. eshte plotesisht e bazuar dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit 7667, date 28.01. 1993 "Per rregjistrin tregtar"

V E N D O S A :

1. Pranimin e kerkeses se bere nga ana e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregtare "KASTPETROL" Sh.a.
2. Depozitimin e vendimit nr. 1 date 15. 04. 2001 te aksionerit te vetem te Shoqerise "KASTPETROL" Sh.a., per shit - blerjen e kuotave ne masen 90 % te kesaj shoqerie ne kete menyre :
Z. Shefqet Kastrati zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar.
Z. Luigj Alijaj zoteron 45% te aksioneve ne kapitalin themeltar.
Z. Shefit Kastrati zoteron 10% te aksioneve ne kapitalin themeltar
3. Urdherohet zyra e rregjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

Enila Coko
[Signature]

20885/2

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 20 885/ 2 i Vendimit.

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 03.07. 2001, para meje gjyqtares Anu'la Copo., gjyqtare prane gjykates se rrethit Tirane, u paraqit personalisht kerkuesi Luigj ALIJAJ, shtetas shqiptar me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. i cili me kerkoi depozitimimin e vendimit nr. 2 te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakoneshme te Aksionereve, date 15. 06. 2001, te Shoqerise "KASTPETROL" Sh.a. me seli ne qytetin e Duresit, per zmadhimin e kapitalit aksioner te shoqerise, nepermjet ritjes se vleres nominale te aksioneve, si pasoje e kontributit ne te holla te aksionereve te shoqerise dhe pasi e gjeta ate konform akteve te shoqerise dhe te ligjit Nr. 7638, date 19. 11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare"

K O N S T A T O V A S E :

Shoqeria Tregtare "KASTPETROL" Sh.a, eshte regjistruar ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr 20 885, date 12. 02. 1999 dhe ushtron aktivitet sipas akteve te themelimit te saj

Shoqeria eshte themeluar me nje kapital fillestar aksioner prej 2. 000. 000. leke dhe me nje pjesmarrje te aksionereve themelues ne kapitalin aksioner ne kete menyre : Aksioneri Shefqet Kastrati zoteron 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar, aksioneri Luigj Alijaj zoteron 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar dhe aksioneri Shefit Kastrati zoteron 10 % te aksioneve ne kapitalin themeltar.

Me vendimin e date 15. 06. 2001 asambleja e jashtezakoneshme e aksionereve, e shoqerise tregtare "KASTPETROL" ka vendosur amadhimin e kapitalit fillestar te shoqerise nepermjet ritjes se vleres nominale te aksioneve, si pasoje e kontributit ne te holla te aksionereve themelues dhe ne perpjestim me pjeset takuese te tyre ne kapitalin themeltar te kesaj shoqerie. Kapitali i shoqerise behet ne 150. 000. 000 leke ishte ne momentin e themelimit te shoqerise nga 2. 000. 000 leke pas rritjes se tij, si pasoje e derdhjes se kontributit ne te holla te aksionereve themelues.

Sipas vendimit te asamblese rezulton se gjendja e zoterimit te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise paraqitet ne kete menyre :

Aksioneri Luigj Alijaj, zoterues i 45 % te aksioneve ne kapitalin aksioner te shoqerise, me numer te aksioneve ne zoterim 900 aksione, me vlere nominale te nje aksioni 1 000 leke, me vlere te kapitalit aksioner 900 000 leke, do te kontribuojne ne rritjen e kapitalit themeltar ne vleren prej 66. 600. 000 leke, shume kjo e derdhur per llogari te shoqerise, sipas mandateve bankare te paraqitura. Kapitali aksioner qe do te zoteroje aksioneri Luigj Alijaj pas zmadhimit te kapitalit si pasoje e kontributit ne te holla te tij, do te jete ne kete gjendje:

Numri i aksioneve	aksione ne zoterim	vlere nominale e nje aksioni
1- 900	900	75. 000

Kapitali aksioner i zoteruar nga ana e aksionerit te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. Luigj Alijaj i shprehur ne vlere leku eshte i barabarte me 67. 500. 000 leke, qe perfaqesojne 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Aksioneri Shefqet Kastrati zoterues i 45 % te aksioneve ne kapitalin aksioner te shoqerise, me numer te aksioneve ne zoterim 900 aksione, me vlere nominale te nje aksioni 1 000 leke, me vlere te kapitalit aksioner 900 000 leke, do te kontribuojne ne rritjen e kapitalit te shoqerise ne shumen prej 66. 600. 000 leke, shume kjo e derdhur per llogari te shoqerise, sipas mandateve bankare te paraqitura. Kapitali aksioner qe do te zoteroje aksioneri Shefqet Kastrati pas zmadhimit do te jete ne kete gjendje :

Numri i aksioneve	aksione ne zoterim	vlere nominale e nje aksioni
901 -1800	900	75. 000

Kapitali aksioner i zoteruar nga ana e aksionerit te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. Shefqet Kastrati i shprehur ne vlere leku, eshte i

barabarte me 67. 500. 000 leke, qe perfaqesojne 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Aksioneri Shefit Kastrati, zoterues i 10 % te aksioneve ne kapitalin aksioner te shoqerise, me numer te aksioneve ne zoterim 200 aksione, me vlere nominale te nje aksioni 1 000 leke, me vlere te kapitalit aksioner 200 000 leke, do te kontribuojne ne rritjen e kapitalit te shoqerise ne shumen prej 14. 800. 000 leke, shume kjo e derdhur per llogari te shoqerise, sipas mandateve bankare te paraqitura. Kapitali aksioner qe do te zoteroje aksioneri Shefit Kastrati pas zmadhimit te kapitalit do te jete ne kete gjendje :

Numri i aksioneve	aksione ne zoterim	vlere nominale e nje aksioni
1801 - 2000	200	75. 000

Kapitali aksioner i zoteruar nga ana e aksionerit te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. Shefit Kastrati i shprehur ne vlere leku, eshte i barabarte me 15. 000. 000 leke, qe perfaqesojne 10 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Pas kontributit ne te holla te aksionereve te shoqerise ne perputhje me aksionet e zoteruara nga ana tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise kapitali aksioner pas zmadhimit te kapitalit si pasoje e ketij kontributi ne te holla do te jete ne kete gjendje :

Aksione ne pronesi te shoqerise	Vlera nominale e nje aksioni
---------------------------------	------------------------------

2000

75. 000

Kapital aksioner i shoqerise i shprehur ne vlere leku i barabarte me 150 000. 000 leke.

Me zmadhimin e kapitalit aksioner te shoqerise, ndryshojne edhe dispozitat perkatese te statutit. Neni 11 i statutit ndryshon ne kete menyre:

"Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 150. 000. 000 leke. Ai eshte i ndare ne 2000 aksione nominative te se njejtës kategori. Çdo njeri prej askioneve ka vlere nominale 75. 000 leke dhe jane te numeruara nga numri 1 deri tek numri 2000 qe perben dhe numrin e fundit te aksionit".

Neni 13 i statutit ndryshon ne kete menyre :

"Kapitali themeltar i shoqerise eshte likujduar plotesisht nga aksioneret e shoqerise "Kastpetrol" Sh.a. dhe zoterohet prej tyre ne kete menyre :

Aksioneri Shqefqet Kastrati zoteron 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise, aksioneri Luigj Aliaj zoteron 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise dhe aksioneri Shefit Kastrati zoteron 10 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise".

Zmadhimi i kapitalit se shoqerise tregtare "Kastpetrol" Sh.a, nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve sipas vendimit nr. 2, date 15. 06. 2001 te mbledhjes se asamblese se jashtezakoneshme eshte bere me pelqimin unanim te aksionereve te kesaj shoqerie, konform kerkesave te nenit 150 te ligjit 7638, date 19. 11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe akteve te shoqerise.

Per sa me siper kerkesa e paraqitur nga ana e Drejtorit Ekzekutiv te shoqerise "KASTPETROL" Sh.a. per depozitimin e vendimit nr. 2, date 15. 06. 2001 te mbledhjes se asamblese se jashtezakoneshme, duhet pranuar si e bazuar ne ligj dhe ne prova dhe sipas objektit te saj.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit Nr. 7638 date, 19. 11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667, date 28. 01. 1993 "Per Rregjistrin tregtar".

V E N D O S A:

1. Pranimin e kerkeses se bere nga ana e Drejtorit Ekzekutiv te shoqerise "KASTPETROL" Sh.a. zotit Luigj Alijaj
2. Depozitimin e vendimit nr. 2, date 15. 06. 2001 te asamblese se jashtezakoneshme te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. per zmadhimin e kapitalit te shoqerise, nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve, si pasoje e kontributit ne te holla te aksionereve themelues te saj, ne perpjestim me pjeset e tyre takuese ne kapitalin fillestar te shoqerise. Gjendja e zoterimit te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. pas zmadhimit te tij do te jete si me poshte :

-Kapitali aksioner i zoteruar nga ana e aksionerit te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. Luigj Alijaj i shprehur ne vlere leku eshte i barabarte me 67. 500. 000 leke, qe perfaqesojne 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Numri i aksioneve	aksione ne zoterim	vlere nominale e nje aksioni
1- 900	900	75. 000

-Kapitali aksioner i zoteruar nga ana e aksionerit te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. Shefqet Kastrati i shprehur ne vlere leku eshte i barabarte me 67. 500. 000 leke, qe perfaqesojne 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Numri i aksioneve	aksione ne zoterim	vlere nominale e nje aksioni
901 -1800	900	75. 000


-Kapitali aksioner i zoteruar nga ana e aksionerit te shoqerise tregtare "KASTPETROL" Sh.a. Shefit Kastrati i shprehur ne vlere leku eshte i barabarte me 15. 000. 000 leke, qe perfaqesojne 10 % te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Numri i aksioneve	aksione ne zoterim	vlere nominale e nje aksioni
1801 - 2000	200	75. 000

3. Kapitali i shoqerise zmadhohet nga 2. 000. 000 leke qe ishte ne momentin e themelimit te shoqerise, ne 150. 000. 000 leke.

4. Urdherohet zyra e regjistrimit te beje ndryshimet ne kollonat perkates te regjistrimit.

GJYQTARE

Enxheta Cep


2.0885/3

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE

Nr 20885/3 vendimit

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 14 PF/2004 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane M. Dedi pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria anonime "**Kastpetrol**" sh.a me Drejtor te Pergjithshem Z.Luigj Aliaj, per depozitim e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise shoqerise,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.20885 date 12.2.1999 eshte themeluar shoqeria "**KASTPETROL**" sh.a me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj. Asambleja e aksionereve te shoqerise me vendimin date 10.6.2004 kane vendosur:

1. Te miratojne transferimin e aksioneve me ane te shitjes qe i perkasin aksionerit Shefqet Kastrati ne dobi te z.Shefit Kastrati 147 aksione ,te identifikuara perkatesisht nga numri 1654 deri ne numrin 1800,me vlere nominale te nje aksioni prej 75.000 leke kundrejt cmimit prej 11.025.000(njembjedhjetemilion e njezetepesemije)Leke.

Perfundimisht aksioneri **Luigj Aliaj** ,mbetet aksioner i shoqerise duke mos ndryshuar vleren e aksioneve qe zoterohen prej tij, perkatesisht me 45 % te aksioneve ne kapitalin themeltar ,e barabarte 67.500.000 (gjashtedhjeteeshtatemilion e peseqindmije) leke.

-Aksioneri **Shefqet Kastrati** mbetet aksioner i shoqerise me 37,65% te aksioneve ne kapitalin themeltar ,e barabarte ne vlere me 56.475.000(pesedhjetegjashte million e katerqind e shtatedhjetepese mije) leke

-Aksioneri **Shefit Kastrati** mbetet aksioner i shoqerise me 17,35% te aksioneve ne kapitalin themeltar ,e barabarte ne vlere me 26.025.000(njezetegjashtemilion e njezetepesemije)leke.

*Depozitimin e kerkeses dhe dokumentave prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993

V E N D O S A

*Pranimin e kerkeses.

*Depozitimin e kerkeses ,vendimit date 10.6.2004 te aksionereve te shoqerise, kontrates se shitjes se aksioneve te paraqitura nga shoqeria **"KASTPETROL" sh.a** duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit tregtar, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

Mani

Seferi
Mani

20885/4

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
Nr 20885/4 vendimit

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 08/09/2004 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane Z. Luigj pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria anonime "**KASTPETROL**" sh.a me Drejtor te Pergjithshem Z.Luigj Aliaj, per depozitim e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise shoqerise,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.20885 date 12.2.1999 eshte themeluar shoqeria "**KASTPETROL**" sh.a me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Me vendimin Nr.3 date 19.7.2004 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise kane vendosur:

- 1.Shkarkimin nga detyra te antareve te Keshillit Mbikqyres te shoqerise te Z.Kujtim Xhavit Caushllari,Ramazan Mat Hoda dhe Z.Bilbil Jonuz Kastrati pasi afati i emerimit te tyre ka perfunduar.**
- 2.Te emerohet ne Keshillin Mbikqyres te Shoqerise "Kastpetrol"sh.a si anetare te zgjedhur nga Asambleja :**
 - a-Z.Ramazan Mat Hoda**
 - b-Hajredin Jonuz Kastrati te zgjedhura nga te punesuarit Z.Bilbil Jonuz Kastrati.**

Me vendimin Nr.1 date 20.07.2004 Keshilli Mbikqyres i shoqerise ka vendosur :

- 1.Shkarkimin nga detyra te Drejtorit te Pergjithshem Z.Luigj Pjeter Aliaj si dhe anetareve te Drejtorise.**
- 2.Te emerohet Drejtor te Pergjithshem te shoqerise "Kastpetrol"sh.a Z.Luigj Pjeter Aliaj.**

3. Te emeroje anetaret e Drejtorise:

a-Z. Bedri Kastrati

b-Z. Uruc Memishi

c-Z. Sezar Beqa

d-Z. Gazmend Kastrati

*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare
Tirane.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e
drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe
Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992


V E N D O S A

*Pranimin e kerkeses.

*Depozitimin e kerkeses, vendimi i asamblese se
jsahtezakonshme, vendimi i Keshillit Mbikqyres te
paraqitura nga shoqeria **"KASTPETROL" sh.a** duke u bere
shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kollonen 4 e
kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te
kuqe.

G J Y Q T A R E

Mening Refuz
[Signature]

DURRES-TANSE


AKT THEMELIMI
PER SHOQERINE ANONIME "KASTPETROL"
(Pa oferte publike)

Mbeshtetur ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" Asambleja e Jashtezakonshme, e perbere nga ortaku i vetem Shefit Kastrati, i biri i Jonuzit , i datelindjes 22.07.1970, lindur ne fshatin Brut te Rrethit te Kuksit, banues ne Durres, lagja nr.1 (Vollga), ne mbledhjen e saj te dates 28.01.1999 miratoi kete akt themelimi per shoqerine tregtare "Kaspetrol" SHA me kushtet si me poshte:

Neni 1

Themelohet shoqeria tregtare "Kaspetrol" me statusin e shoqerise anonime pa oferte publike. Aksioner themelues eshte ortaku i vetem Shefit Kastrati.

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte "Kaspetrol" SHA dhe ai i shkurtuar "KP" SHA

Neni 3

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe ne vende te tjera ne baze te ligjit e percaktimit te statutit.

Neni 4

Shoqeria themelohet per te vepruar per nje periudhe 50 vjeçare duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar. Afati i mesiper mund te perseritet me vendim te Asamblese.

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne Shkozet te rrethit Durres.
Shoqeria ka vulen e saj sipas percaktimeve te statutit.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte importi, eksporti dhe tregtimi brenda vendit i naftes gazit e nenprodukteve te tyre nepermjet krijimit te instalimeve e impianteve te pershtatshme per ushtrimin e nje veprimtarie te tille. Shoqeria, duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e parashikuar me siper.



- 2 -

Neni 7

Shoqeria mund te kete pjesmarrje ose te kontrolloje shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte apo te ndryshem nga i saj.

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2000000 leke. Ai eshte i ndare ne 2000 aksione nominative te se njejtes kategori. Çdo njeri prej aksioneve ka vlere nominale 1000 leke.

Neni 9

Kapitali themeltar perbehet nga kontribute ne para. Ato jane te depozituara teresisht ne Banke dhe te shlyera qe ne momentin e themelimit.

Neni 10

Kapitali themeltar zoterohet teresisht nga ortakut i vetem Shefit Kastrati.

Neni 11

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja

Keshilli Mbikqyres

Drejtoria

Perberja, rregullat e thirrjes se tyre dhe kompetencat percaktohen ne statut.

Neni 12

Per sa kohe qe i tere kapitali themeltar zoterohet nga ortakut i vetem, Asambleja e zakonshme dhe e Jashtezakonshme perbehet vetem prej tij.

Neni 13

Veprimtaria e shoqerise eshte e organizuar me bilanc financiar me llogarite humbje fitime gjate vitit ushtrimor.

Viti ushtrimor fillon me 1 janar e mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik.

Neni 14

Fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqerise, pas zbritjes se rezerves ligjore ndahen sipas percaktimeve te Asamblese. Fondi i caktuar per dividend i takon zoteruesit te aksioneve.



- 3 -

Neni 15

Shoqëria mund të likujdohet para afatit vetëm në rastet e parashikuara me ligj ose në bazë të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

Neni 16

Asambleja ka miratuar statutin e shoqërisë që është pjesë e pandare e këtij akti themelimi.

Neni 17

Ndryshimet në këtë akt themelimi dhe në statut janë kompetence vetëm e Asamblesë së Jashtëzakonshme.

ORTAKU I VETEM

SHEFIT KASTRATI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 919 Rep.
Nr. 142 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 11.02.1999 (nentedhjetenente), para meje noterit publik Halil Sinani, me zyre ne Rrugen "Puntoret e Rilindjes" Tirane, u paraqit personalisht Zoti Shefit Kastrati, i datelindjes 22 korrik 1970, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta personale me nr.0958038, i cili me kerkoj vertetimin e nenshkrimit te bere ne aktin e themelimit te shoqerise anonime pa oferte publike "Kastpetrol" Durres.

Une noteri pasi u binda per vullnetin e deklarimit lejova nenshkrimin dhe e legalizova sipas ligjit.

NOTERI
HALIL SINANI



STATUTI

I SHOQERISE ANONIME "KASTPETROL"



Mbeshtetur ne ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" si dhe ne aktin e themelimit, Asambleja e Jashtezakonshme, e perbere nga ortaku i vetem, nxjerr kete statut per ushtrimin e veprimtarise se shoqerise anonime "KastPetrol":

KREU I

EMERTIMI, FORMA, SELIA

Neni 1

Themelohet nje shoqeri tregtare me statusin e shoqerise anonime pa oferte publike me emertimin "KastPetrol" SHA dhe me emertimin e shkurtuar KPSHA .

Neni 2

Zoterues i aksioneve te shoqerise eshte ortaku i vetem themelues Shefit Kastrati siç rezulton nga akti i themelimit dhe nga dokumenti i shlyerjes se aksioneve te kapitalit themeltar.

Neni 3

Shoqeria mund te shndrohet ne nje shoqeri anonime me oferte publike ose ne nje forme tjeter duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 4

Shoqeria eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", ligjit nr. 7661 date 19.01.1993 "Per kontabilitetin dhe legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.



- 2 -

Neni 5

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te çele filiale, perfaqesi apo agjenci si dhe te kete pjesmarrje apo te krijojë shoqeri te tjera jashte vendit duke respektuar legjislacionin e vendeve ku ato ngrihen.

Neni 6

Shoqeria themelohet per te vepruar per nje peridhe 50 vjeçare duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar. Me vendim te Asamblese periudha e mesiperme mund te riperseritet.

Neni 7

Shoqeria ka vulen e saj e cila ka formen (katrore, rumbullake ose vezake) Ne qender te saj eshte perkrenarja e Skenderbeut dhe rreth eshte shkruar: Shoqeria Anonime "KastPetrol" Durres Albania.

Neni 8

Selia e shoqerise eshte ne Shkozet te Rrethit Durres. Shoqeria mund te çele edhe seli sekondare dispozitat ligjore ne fuqi. Ndryshimi i selise eshte kompetence e Asamblese.

KREU II

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 9

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte importi eksporti dhe tregtimi brenda vendit i naftes, gazit e nenprodukteve te tyre nepermjet krijimit te instalimeve e impianteve te pershtatshme per ushrimin e nje veprimtarie te tille.

Shoqeria, duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e parashikuar ne paragrafin e mesiperme



Neni 10

Shoqeria mund te kete pjesmarrje ose te kontrolloje shoqeri te tjera qe kane objekt te njellojte apo te ndryshme nga ai i saj.

KREU III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2000000 leke. Ai eshte i ndare ne 2000 aksione nominative te se njejtës kategori. Çdo njeri prej aksioneve ka vlere nominale 1000 leke dhe jane te numeruara nga nr.1 deri tek nr.2000 qe perben dhe numrin e fundit te aksionit.

Neni 12

Kapitali themeltar perbehet nga kontribute ne para. Ato jane te depozituara teresisht ne Banke duke qene te shlyera qe ne momentin e themelimit te gjitha aksionet e shoqerise.

Neni 13

Kapitali themeltar eshte i likujduar plotesisht nga ortaku i vetem dhe zoterohet teresisht nga ai.

Neni 14

Kapitali themeltar mund te zmadhohet sipas menyrave e modaliteteve te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim.

Neni 15

Asambleja mund te vendose kur eshte rasti edhe per zvoglimin e kapitalit themeltar brenda kufirit minimal te kerkuar nga ligji. Ne asnje rast zvoglimi nuk mund te cenoje raportet e pjesmarrjes se ortakeve ne kapitalin themeltar.



KREU IV

AKSIONERET DHE AKSIONET

Neni 16

Aksionere te shoqerise konsiderohen personat fizike ose juridike qe vene ne zoterim aksione te shoqerise me te gjitha menytrat e parashikuara nga ligji. Pronesia mbi aksionet e shoqerise permban aderimin e plote ne statutin e shoqerise, pjesmarrjen ose perfaqesimin ne Asamble kur plotesohen kushtet e percaktuara ne kete statut, pjesmarrjen ne fitimet e shoqerise si dhe realizimin e çdo te drejte tjeter te njohur me ligj apo sipas normave te aktit te themelimit apo te ketij statuti.

Neni 17

Çdo aksioner ka te drejten e pjesmarrjes ne fitimet e shperndarshme te shoqerise ne forme dividenti. Dividenti qe i takon çdo aksioneri eshte ne perputhje me numrin e aksioneve te zoteruara.

Neni 18

Aksioneret qe zoterojne nje numer jo me te vogel se 10 aksione te shoqerise kane te drejten e pjesmarrjes apo te perfaqesimit ne mbledhjet e Asamblese se Zakonshme. Ky kufizim nuk eshte i vlefshem per mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme.

Neni 19

Aksioneret perballojne humbjet e shoqerise vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20

Aksioneret kane te drejten e informimit per veprimtarine e shoqerise si dhe ate te kerkimit te dokumentave sipas kushteve te percaktuara ne dispozitat ligjore.



Neni 21

Aksioneret, ne mungese te kushteve per pjesmarrjen e drejtperdrejte, kane te drejte te perfaqesohen ne mbledhjen e Asamblese, duke respektuar per kete dispozitat e procedurat e kerkuara nga ligja e statuti.

Neni 22

Aksioneret qe zoterojne aksione nominative, ne rastin e ndryshimit te vendbanimit te tyre te perhershem jane te detyruar te lajmerojne me shkrim drejtorine e shoqerise per kete ndryshim. Moslajmerimi i ndryshimit te vendbanimit te perhershem e shkarkon drejtorine e shoqerise nga pergjegjesia per mungesen e lajmerimit per mbledhjen e Asamblese.

Neni 23

Aksionet e shoqerise jane te formes nominative dhe te se njejtës kategori. Asambleja, kur jane kushtet, mund te vendose per emetimin e aksioneve te formave e kategorive te tjera.

Neni 24

Kur shoqeria nuk permbush kushtet e kerkuara per regjistrimin ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve, ajo eshte e detyruar t'u leshoje aksionereve, me kerkesen e tyre vertetime per numrin e aksioneve qe ata zoterojne, kategorine apo vleren nominale te tyre.

Neni 25

Shoqeria mban librin e aksionereve. Ky liber eshte i vertetuar per numrin e faqeve nga noteri. Ne librin e aksionereve shenohen:

- Identiteti i plote i çdo aksioneri e vendbanimi i perhershëm i tij;
- Numri dhe kategoria e aksioneve qe zoteron çdo aksioner, vlera nominale e nje aksioni si dhe vlera totale e aksioneve qe zoteron aksioneri;
- Menyra dhe data e zoterimit te aksioneve nga aksioneri.

Çdo aksioner ka te drejte te nenshkruaje ne fund te rrjeshtave ku jane shenuar te dhenat qe i perkasin atij.



Neni 26

Aksionet e shoqerise te çfaredo lloj forme apo kategorie, jane lirisht te tregtueshme.

Neni 27

Ne rastin e trashegimise per aksionet zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 28

Ndryshimi i pronesise se aksioneve si rrjedhoje e nje shitje apo transferimi behet duke respektuar procedurat e kerkuara nga ligja. Perfituesi i aksioneve eshte i detyruar qe te njoftoje ne kete rast drejtorine e shoqerise per ndryshimin e pronesise si dhe te depozitoje prane saj apo Qendres se Regjistrimit te Aksioneve dokumentat perkatese qe vertetojne kryerjen e ketij ndryshimi.

Neni 29

Ndryshimi i pronesise te aksioneve nominative eshte i detyruar te behet me akt noterial.

Neni 30

Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar te beje ndryshimet perkatese ne librin e aksionereve ne rastin e ndryshimit te pronesise se aksioneve kur jane respektuar normat ligjore ne fuqi dhe percaktimet e ketij statuti.

Neni 31

Ne rastin e zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise, aksionet e nenshkruara ne para duhet te shlyhen sipas modaliteteve te caktuara nga Asambleja e Jashtezakonshme. Shlyerja e ketyre aksioneve nuk mund te jete me e ulet se 1/4 e vleres nominale. Shlyerja e vleres nominale te mbetur duhet te kryhet ne nje apo disa keste, me kerkese te drejtorise dhe brenda afateve ligjore te percaktuara.



Neni 32

Kerkesat per shlyerjen e aksioneve u behen te njojtura nenshkruesve te pakten 30 dite para dates se caktuar per çdo derdhje, me leter rekomande, te adresuar tek çdo titullar i aksioneve sipas vendbanimit te perhershëm te tij te shenuar ne librin e aksioneve. Çdo vonese ne ne derdhjen e shumave te caktuara si me siper, sjell pagimin e interesave ne perqindje ligjore dhe kjo pavaresisht nga veprimi personal qe drejtoria mund te ushtroje ndaj aksionerit qe nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga ligji.

KREU V

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 33

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja,
2. Keshilli Mbikqyres,
3. Drejtoria.

Neni 34

Asambleja eshte organi me i larte drejtues i shoqerise. Ajo perbehet nga teresia e aksionereve qe zoterojne aksione te shoqerise e qe jane te regjistruar ne librin e aksioneve te shoqerise ne kohen e dergimit te lajmerimit apo te shpalljes se njoftimit per mbledhjen e Asamblese. Ne rastin e zoterimit te aksioneve nga nje ortak i vetem Asambleja perbehet nga ortaku i vetem.

Neni 35

Asambleja eshte e Zakonshme ose e Jashtezakonshme. Asambleja konsiderohet e Jashtezakonshme vetem kur nje gje e tille eshte e shprehur posaçerisht ne njoftimin e derguar dhe rendi i dites i saj permбан qofte dhe nje pike qe i perket kompetencave te Asamblese se Jashtezakonshme. Me njoftim te derguar do te kuptohet lajmerimi apo njoftimi i bere per mbledhjen e Asamblese sipas menyrave te percaktuara ne kete statut



Neni 36

Asambleja mbledhet ne seline e regjistruar te shoqerise dhe ne pamundesi ne nje vend tjeter te pershtatshem brenda qytetit ku eshte vendosur selia, me kusht qe ky vend te percaktohet saktesisht ne lajmerimin apo njoftimin e thirrjes.

Neni 37

Te drejten dhe detyrimin per thirrjen e Asamblese e kane:

- Keshilli Mbikqyres dhe Drejtoria.

Te drejten per thirrjen e Asamblese e kane edhe:

1. Nje apo disa aksionere qe zoterojne se bashku jo me pak se 1/10 e kapitalit themeltar te shoqerise;
2. Ekspertet kontabel te autorizuar;
3. Nje mandatmbajtes i caktuar nga Gjykata sipas dispozitave ligjore;
4. Likujdatoret.

Asambleja e Zakonshme nuk mund te thirret me pare se 6 muaj nga data e mbledhjes se meparshme ndersa ajo e Jashtezakonshme jo me pare se 3 muaj nga data e mbledhjes se meparshme te Asamblese.

Neni 38

Thirrja e Asamblese behet nepermjet dergimit te njoftimit me leter rekomande te derguar ne vendbanimin e perhershem te deklaruar te çdo personi qe zoteron aksione ne masen e mjaftueshme per pjesmarrjen ne Asamble dhe qe ne momentin e njoftimit eshte i regjistruar ne librin e aksionereve te shoqerise ose me publikimin e njoftimit ne gazeten e autorizuar per njoftime ligjore duke bere njekoheesisht dhe nje njoftim nepermjet radiotelevizionit publik.

Njoftimi duhet te permbaje detyrimisht te gjitha kerkesat e percaktuara nga ligja.

Neni 39

Rendi i dites se Asamblese percaktohet dhe nenshkruhet nga organi apo personi qe ka te drejten e thirrjes se Asamblese. Ai qe ben thirrjen e Asamblese pergatit dhe dokumentat perkatese per shqyrtim nga Asambleja. Ne te gjitha rastet Drejtoria ka detyrimin per stampimin e dergimin e lajmerimeve, per sigurimin e vendit te pershtatshem per



mbledhje si dhe per stampimin e dokumentave te nevojshme per mbledhjen e Asamblese te pergatitura nga ai qe ka bere thirrjen e Asamblese.

Ne rendin e dites shenohen çeshtjet qe do te shqyrtohen, data, ora e vendi i mbledhjes, natyra e jashtezakonshme e Asamblese kur eshte rasti.

Neni 40

Asambleja e Jashtezakonshme vendos per ndryshimet ne aktet e themelimit, per ritjen apo zvogelimin e kapitalit themeltar si dhe per likuidimin e shoqerise. Ajo mund te vendose edhe per çeshtje te tjera kur ato, se bashku me nje nga çeshtjet e parashikuara me siper jane percaktuar ne rendin e dites te Asamblese.

Neni 41

Asambleja e Zakonshme merr çdo vendim, perveç atyre te permendura ne nenin 40 te ketij statuti.

Neni 42

Asamblete e Zakonshme ose te Jashtezakonshme dhe vendimet e tyre jane te vlefshme kur thirrja, pjesmarrja, shqyrtimi e votimi jane bere konform kerkesave te ligjes dhe percaktimeve te ketij statuti.

Neni 43

Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose nga nje person nga radhet e aksionereve i zgjedhur nga Asambleja. Ne rastin e ortakut te vetem nuk eshte i nevojshem drejtuesi i Asamblese.

Neni 44

Drejtuesi i Asamblese eshte pergjegjes per shqyrtimin e dokumentave ne Asamble sipas rendit te dites te percaktuar ne njoftimin e derguar çdo aksioneri, per zhvillimin e votimeve, nxjerrjen e rezultatit te tyre dhe marrjen e firmosjen e vendimeve sipas vullnetit te Asamblese. Aktet e Asamblese se Jashtezakonshme dhe ato qe lidhen me depozitime apo regjistrime ne Gjykate vertetohen edhe nga noteri. Aktet e tjera



firmosen vetem nga drejtuesi i Asamblese dhe mbajtési i procesverbalit te mbledhjes.

Neni 45

Çdo aksioner jep te drejten e nje vote. Çdo aksioner ka aq vota sa aksione zoteron. Per efekt te votimit teresia e Asamblese ka 2000 vota.

Neni 46

Asambleja e Jashtezakonshme konsiderohet e rregullt dhe mund te marre vendime te vlefshme kur ne te jane te pranishem ose perfaqesohen aksioneret qe zoterojne te pakten 1/2 e kapitalit themeltar. Kur kushti i mesiperm nuk plotesohet, kerkohet nje mbledhje e dyte e Asamblese, me te njejtin rend dite, ne te cilen duhet te jene te pranishem ose te perfaqesuar aksioneret qe zoterojne jo me pak se 1/4 e kapitalit themeltar. Ne çdo rast Asambleja e Jashtezakonshme merr vendime me nje shumice prej 3/4 e tersise se votave te aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 47

Asambleja e Zakonshme konsiderohet e rregullt e merr vendime te vlefshme kur ne te marrin pjese ose jane te perfaqesuar aksioneret qe zoterojne jo me pak se 1/4 e kapitalit themeltar te shoqerise. Ne rast te mosplotesimit te kushtit te mesiperm, kerkohet nje mbledhje e dyte, me te njejtin rend dite, ne te cilen nuk kerkohet shumice e cilesuar. Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

Neni 48

Anetaret e Keshillit Mbikqyres, anetaret e Drejtorise dhe eksperti kontabel i autorizuar e kane te detyrueshme pjesmarrjen ne Asamble me perjashtim te rasteve kur nje gje e tille eshte e pamundur per shkaqe objektive apo per çeshtje pune ne favor te shoqerise.

Neni 49

Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga 3 anetare, 2 prej te cileve zgjidhen nga Asambleja. Ne rastin e ortakut te vetem 2 anetaret e Keshillit



Mbikqyres zgjidhen prej tij. Anetari i trete i Keshillit Mbikqyres zgjidhet nga te punesuarit ne shoqeri sipas procedurave te percaktuara ne ligj. Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te jene edhe anetare te Drejtorise. Ata mund te zgjidhen edhe jashte bashkesise se ortakeve.

Neni 50

Anetaret e Keshillit Mbikqyres zgjidhen per nje periudhe tre vjeçare. Ne rast te mbetjes bosh te nje vendi te anetarit te Keshillit Mbikqyres, ky i fundit emerom nje anetar tjetër me kusht qe ky emerim te miratohet nga mbledhja me e pare e Asamblese.

Neni 51

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqjen nga funksioni i tyre me ane te nje deklarate me shkrim drejtuar Keshillit Mbikqyres e dorezuar kryetarit te tij jo me von se 15 dite me pare nga mbledhja e radhes e Keshillit Mbikqyres.

Asambleja mund te revokojë ne çdo kohe anetaret e Keshillit Mbikqyres, kur pa shkaqe te arsyeshme nuk permbushin detyren e ngarkuar.

Neni 52

Keshilli Mbikqyres zgjedh nga radhet e tij nje Kryetar qe ngarkohet me organizimin e mbledhjeve te Keshilli, me drejtimin e debatit per çeshtjet qe shqyrtohen. Kryetari ushtron funksionin e tij gjate tere periudhes se mandatit te Keshillit Mbikqyres me perjashtim te rastit kur jep doreheqje ose largohet nga Keshilli Mbikqyres per shkaqe te tjera legale. Anetari i Keshillit Mbikqyres i zgjedhur nga te punesuarit ne shoqeri nuk mund te jete Kryetar i Keshillit Mbikqyres.

Neni 53

Keshilli Mbikqyres merr vendime te vlefshme kur ne mbledhjen e tij eshte e pranishme te pakten 1/2 e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te votave te te pranishmeve. Ne rast barazimi te votave vota e kryetarit eshte percaktuese. Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te perfaqesohen ne mbledhjet e Keshillit.

Neni 54



Ne rast te pamundesise per te marre pjese ne mbledhje te Kryetarit te Keshillit Mbikqyres, mbledhja drejtohet nga anetari tjetër i zgjedhur nga Asambleja, vota e te cilit ka perparesine e percaktuar per Kryetarin ne nenin 52 te ketij statuti.

Neni 55

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj drejtorise per administrimin e pasurise se shoqerise nga ana e kesaj te fundit. Keshilli Mbikqyres mund te vendose qe anetaret e tij te kryejne verifikime e kontrole per çeshtje qe ai i çmon te arsyeshme ne nje moment te caktuar si dhe te kerkoje te njihet me çdo dokument qe disponohet nga drejtoria e shoqerise dhe qe Keshilli Mbikqyres e gjykon te nevojshem per plotesimin e detyres se tij.

Keshilli Mbikqyres, brenda kompetencave te njohura nga ligji e ky statut, merr vendime e shfaq pikpamjet e tij mbi raportet periodike apo vjetore te drejtorise si dhe per çdo dokument tjetër te paraqitur ne Asamble.

Neni 56

Keshilli Mbikqyres vendos:

- Per emerimin e shkarkimin e drejtorit te pergjithshem dhe anetareve te tjere te drejtorise;
 - Per kompetencat dhe shperblimin e anetareve te drejtorise;
 - Per strukturen organizative te shoqerise dhe rregulloren e funksionimit te administrates se drejtorise e hallkave vartese te saj;
 - Çeljen e llogarive e depozitimin e shumave ne banka jashte territorit te Republikes se Shqiperise, me perjashtim te rasteve kur nje gje e tille lidhet me livrimin e zakonshem te mallrave te importit sipas kontratave apo marreveshjeve perkatese;
 - Per çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres apo anetareve te drejtorise, qofte ose jo kjo e drejtperdrejte.
- Ndermjet dy mbledhjeve te Asamblese Keshilli Mbikqyres miraton:
- Ndryshimet ne programin vjetor;
 - Hapjen e veprimtarive te reja te papercaktuara shprehimisht ne statut;
 - Hapjen e degeve, agjencive, perfaqesive e filialeve jashte vendit apo mbylljen e atyre ekzistuese;
 - Pjesmarrjen ne shoqeri te tjera apo krijimin e shoqerive te reja;
 - Marrjen e huave afatmesme e afatgjate;



- Shitblerjen e pasurive te paluajtshme, dhenien e dorzaneve e garancive, kur keto kalojne veprimtarine e zakonshme te shoqerise;
- Shitblerjen e pasurive te patundshme.

Neni 57

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres thirren jo me rralle se 4 here ne vit. Ato organizohen me lajmerimin me shkrim te Kryetarit dhe ne mungese te tij te anetarit tjeter te zgjedhur nga Asambleja. Lajmerimi u dergohet anetareve te pakten 15 dite para dates se mbledhjes. Ne lajmerim duhet te jene te shenuara data, ora e vendi i zhvillimit te mbledhjes, rendi i dites i saj si dhe menyra e vendi i njohjes me dokumentat qe do te paraqiten ne mbledhje. Zakonisht mbledhja e Keshillit Mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise.

Neni 58

Antaret e Keshillit Mbikqyres mund te shtrojne per diskutim edhe ceshtje te tjera qe nuk jane ne rendin e dites me kusht qe nje gje e tille te miratohet nga anetaret e tjere pjesmarres. Anetaret e Drejtorise marrin pjese ne mbledhjet e Keshillit Mbikqyres me perjashtim te kohes kur diskutohet emerimi apo shkarkimi i tyre.

Neni 59

Ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres mbahet proçesverbal i cili firmoset nga te gjithë anetaret e pranishem. Vendimet e Keshillit Mbikqyres nxirren ne forme te shkruar dhe firmosen nga kryesuesi i mbledhjes. Deklarata ne emer te Keshillit Mbikqyres ben veten Kryetari i tij.

Neni 60

Anetaret e Keshillit Mbikqyres shperblehen per kryerjen e funksioneve te tyre. Shperblimi percaktohet nga Asambleja. Ata marrin gjithashtu kompensimet perkatese per shpenzimet qe kryejne ne rastin e ngarkimit me detyra te veçanta nga ana e Keshillit Mbikqyres.



Neni 61

Zgjedhja e nje anetari te Keshillit Mbikqyres apo kryerja e funksioneve prej tij duhet te permbushe proceduren e kerkuar nga ligja dhe te respektoje perjashtimet apo papajtueshmerite qe percaktohen ne ligj.

Neni 62

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

Te zgjedhur nga Asambleja:

1. Kujtim Xhavit Çausllari
2. Ramazan Mat Hoda

I zgjedhur nga te punesuarit

1. Bilbil Jonuz Kastrati

Neni 63

Shoqeria drejtohet nga nje drejtori qe mund te perbehet nga disa anetare, nga te cilet njeri emerohet drejtor i pergjithshem. Ne rast se drejtoria perbehet vetem nga nje anetar atehere ky emerohet drejtor i pergjithshem. Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe 4 vjeçare. Anetaret e drejtorise mund te japin doreheqje para mbarimit te mandatit duke paraqitur nje kerkese me shkrim para Keshillit Mbikqyres jo me von se 30 dite para dates se mbledhjes me te afert te ketij Keshilli. Anetari i drejtorise qe ka paraqitur doreheqjen eshte pergjegjies per kryerjen e funksioneve nga ana e tij deri ne mbledhjen e pare te Keshillit Mbikqyres ne te cilen shqyrtohet kerkesa e tij.

Neni 64

Drejtori i pergjithshem i paraqet Keshillit Mbikqyres raport mbi veprimtarine e shoqerise çdo 3 muaj. Brenda 3 muajve te pare te çdo viti pasardhes drejtori i pergjithshem pergatit dhe i paraqet Keshillit Mbikqyres raportin vjetor, bilancin dhe llogarite vjetore. Bilanci vjetor i pergatitur nga drejtori vihet ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar per verifikimin e llogarive.



- 15 -

Neni 65

Drejtori i Pergjithshem eshte pergjegjes per pergatitjen e mbledhjeve te Asamblese e te Keshillit Mbikqyres> Ai ka te gjitha kompetencat per ushtrimin e veprimtarise se zakonshme te shoqerise. Ne veprimtarine e tij drejtori i pergjithshem zbaton ligjet ne fuqi, vendimet e Asamblese, normat e ketij statuti si dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres te marra brenda kompetencave te tij.

Neni 66

Drejtori i Pergjithshem perfaqeson shoqerine ne te gjitha marredheniet juridiko civile me te tretet dhe me gjithe organet shteterore apo gjyqesore. Per periudhen e pare 4 vjeçare Drejtori Pergjithshem caktohet Luigj Aliaj.

Neni 67

Anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe te drejtorise jane pergjegjes per kryerjen e detyrave te tyre dhe miradministrimin e pasurise se shoqerise. Pergjegjesia e tyre eshte sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

KREU VI


USHTRIMI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

Neni 68

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar e mbaron me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik. Ben perjashtim viti i fillimit te veprimtarise ne te cilin si date e filimit do te merret ajo e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar.

Neni 69

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise e te veprimtarise se saj ne perputhje me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit vjetor Drejtoria ben inventarin dhe llogarite vjetore sipas dispozitave ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin e pasurise se shoqerise gjate vitit financiar. Dokumentat e mesiperme paraqiten ne mbledhjen e Asamblese.



Neni 70

Rezultati i ushtrimit vjetor percaktohet si diference ndermjet te ardhurave e shpenzimeve, duke perfshire ne keto te fundit edhe amortizimet. Nga fitimet e ushtrimit, te pakesuara kur eshte rasti me humbjet e vitit te kaluar, mbi bazen e raporteve te Keshillit Mbikqyres, te Drejtorise dhe te eksperteve kontabel te autorizuar, Asambleja miraton bilancin vjetor duke percaktuar destinacionin e fondeve perfshire dhe pjesen qe ndahet si dividend. Dividenti i percaktuar nga Asambleja ndahet nga Drejtoria sipas % se aksioneve qe zoteron secili aksioner.

Neni 71

Ne perdorimin e fitimit te vitit ushtrimor apo pasqyrimin e humbjeve Asambleja respekton te gjitha dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 72

Kontrolli i llogarive vjetore ushtrohet nga eksperti kontabel i autorizuar i zgjedhur nga Asambleja. Eksperti i pare kontabel i autorizuar eshte Znj. Marie Dushi.

KREU VII

NDARJA, BASHKIMI E LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 73

Shoqeria mund te ndahet ose te bashkohet me shoqeri te tjera me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme duke respektuar normat e percaktuara nga ligji dhe ky statut.

Neni 74

Likujdimi i shoqerise behet ne rastet e parashikuara ne ligj ose me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme. Vendimi i likujdimit te shoqerise duhet t'u behet i njohur te gjitha aksionereve nepermjet publikimit te tij ne mjetet e informimit publik dhe ne organin e autorizuar per njoftime ligjore. Likujdimi i shoqerise behet duke respektuar procedurat ligjore.





- 17 -

Te ardhurat e realizuara nga likuidimi, pas shlyerjes se çdo detyrimi, ndahen ndermjet aksionereve sipas pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themeltar.

KREU VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 75

Çdo ndryshim ne kete statut eshte ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme.

Neni 76

Per gjithçka nuk eshte shprehur posaçerisht ne kete statut i referohet dispozitave ligjore ne fuqi per shoqerite tregtare.

Neni 77

Ky statut nenshkruhet nga ortakut i vetem ne Asamblene e Jashtezakonshme themeluese te shoqerise me daten 28.01.1999

ORTAKU I VETEM

SHEFIT KASTRATI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 920 Rep.
Nr. 143 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 11.02.1999 (nentedhjeteeente), para meje noterit publik Halil Sinani, me zyre ne Rrugen "Puntoret e Rilindjes" Tirane, u paraqit personalisht Zoti Shefit Kastrati, i datelindjes 22 korrik 1970, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta personale me nr.0958038, i cili me kerkoj vertetimin e nenshkrimit te bere ne Statutin e shoqerise anonime pa oferte publike "Kastpetrol" Durres.

Une noteri pasi u binda per vullnetin e deklarimit lejova nenshkrimin dhe e legalizova sipas ligjit.

NOTERI
HALIL SINANI



V E N D I M

Nr.3 date 19.07.2004

“PER EMERIMIN E KESHILLIT MBIKQYRES TE SHOQERISE KASTPETROL SHA”

**Asambleja e Jashtezakoneshme e shoqerise kastpetrol sh.a e perber nga
ortaket:**

- 1.Shefqet kastrati**
- 2.Luigj Aliaj**
- 3.Shefit Kastrati**

E mbledhur ditën e Hënë me datë 19.07.2004 ,pasi shqyrtoi aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise “**Kastpetrol sh.a** “ dhe projektin e paraqitur per keshillin mbikqyres:

K O N S T A T O I :

Se me vendimin e dates 28.01.1999 , Asambleja e jashtezakoneshme e themeluesit te shoqerise kastpetrol sh.a jane emeruar ne keshillin mbikqyres te saj **Z.Kujtim Xhavit Çaushllari, Z.Ramazan Mat Hoda** dhe nga te punesuarit eshte zgjedhur **Z.Bilbil Jonuz Kastrati**.

Ne baze te nenit 50 te statutit te shoqerise kastpetrol sh.a rezulton se anetaret e mesiperme jane zgjedhur per nje periudh tre vjeçare.

Per keto arsye :

Bazuar ne ligjin nr.7638 dt.19.11.1992 “**Per Shoqerit tregetare**” :